REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 136/17
Datë/Datum. 05.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Ministrisë së Shëndetësisë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit Agon Hoti - Ekspert Teknik		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **136/17** e OE **"Medical Group"** - Prishtinë.		
Datë:	05.06.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 11.05.2017 me Nr. **136/17** nga OE **"Medical Group"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës: **"Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24**, me numër të prokurimit: 206/17/086/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministrisë së Shëndetësisë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRISË SË SHËNDETËSISË.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **MEDICAL GROUP.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		24.05.2017		**24.05.2017**		**05.06.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 11.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **136/17** e parashtruar nga OE **"Medical Group"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24**, me numër të prokurimit: 206/17/086/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Ministrisë së Shëndetësisë (MSH).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "Medical Group", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Medical Group"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 26 – Nënshkrimi i kontratave publike;
Neni 27 - Dosja e tenderit;
Neni 28 – Specifikimet teknike;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 69 - Aftësia teknike dhe / ose profesionale.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Autoriteti Kontraktues për LOT 24 eliminon si të papërgjegjshëm ofertën e Medical Group ShPK, e cila sipas autorizimit ka përfaqësuar kompaninë farmaceutike Amerikane Pfizer e cila është e rankuar me prodhimet e veta si kompania numër një në botë, dhe synon të shpërblejë me Kontratë Operatorin LIRI-Med, i cili sipas autorizimit ka përfaqësuar kompaninë Kineze shumë më të shtrejtë, duke dëmtuar Buxhetin e Kosovës sakt për. 627.000.00 Euro. Kjo me arsyetimin e paqëndrueshëm dhe të pabazuar se përkundër se produkti i Operatorit Ekonomik të eliminuar e përmban dozën brenda kufive të specifikuar në Dosje të Tenderit nuk përputhet volumi i kërkuar për atë dozë.Në mënyrë të thjeshtuar, nëse me tender kërkohet paracetamol i cili ka dozë prej 500 mg - deri në 1000mg për të trajtuar gripin, Medical Group LLC ka ofertuar me paracetamol të kompanisë më të njohur në botë me dozë 700 mg. Përkundër kësai, Medical Group ShPK është eliminuar për shkak se volumi/madhësia e hapit është në e vogël në krahasim me kompaninë kinezë. Volumi/madhësia më e vogël është fakt që paraqet efekt pozitiv nga aspekti mjekësor. Sa më e vogël volumi/madhësia për të njejtën dozë, aq më mirë për pacientin. Dhe për këtë vendim buxheti Kosovës synon të furnizohet nga kinezët dhe të paguaj 627.000.00 Euro më shumë.

Me këtë vendim, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje:

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Kjo pasi ka shpallur si fitues kompaninë me çmim më të lartë, dhe në mënyrë të kundërligjshme ka

eliminuar Operatorin Ekonomik ankues, i cili ka paraqitur tender të përgjegjshëm dhe me çmim shumë më të lirë. Eliminohet Operatori Ekonomik Medical Group ShPK duke përfaqësuar prodhuesin kryesor farmaceutik lider botëror me ofertë prej 627,000.00 Euro më të lirë se produkti kinez i rekomanduar për shpërblim me Kontratë nga AK. Në anën tjetër edhe operatori i rekomanduar për Kontratë me produktin kinez është i papërgjegjshëm për shkak se Autorizim Marketingu i ofruar nuk përmban informacioni për dozën sipas Njësive Ndërkombëtare (TU) siq është kërkuar në dosjen e tenderit.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale në lidhje me pikat 9 të Dosjes së Tenderit

Operatori Ekonomik Ankues Medical Group LLC ka ofertuar me produkt i cili në tërësi përputhet me kërkesat e Dosjes së Tenderit, më specifikisht me dozën e Kërkuar.

Doza e ofertuar, me 2500 IU, sikurse dëshmohet me Autorizim Marketing, është në tërësi në përputhje Dosjen e Tenderit. Kjo përkundër se ne Letren Standarde për Tenderuesin e Eliminuar Ministria e Shëndetësisë tregon se fare nuk e ka analizuar ofertën e Medical Group ShPK pasi vlerëson se ka dorëzuar tender me dozë 2000 IU. Kjo tregon se Autorizim Marketingu i Medical Group ShPK nuk është analizuar dhe vlersuar fare.

Volumi në të cilin është e tretur doza, 0.2 dhe 0.4 ml, është kriter tërësisht i parëndësishëm as nga aspekti teknik dhe as nga aspekti klinik dhe mjekësor dhe me qëllimin e eliminimit të ofertave të paraqitura në përputhje me dozën. Përkundrazi, sa më e vogël volumi ku disperzohet doza, aq më shumë avantazh për pacientin, më pak dhembje pasi ordinohet subcutan më shpejt përthithet dhe më shpejt reagon.

Neni 27 dhe 28 Dosja e Tenderit dhe Specifikacionet Teknike

- Nëse pranohet interpretimi diskriminues, tendencioz dhe kundërligjor i Ministrisë së Shëndetësë, atëher duhet vendosur se Dosja e tenderit është hartuar në mënyrë diskriminuese me efekt të eliminimit të konkurrencës. Kjo pasi vetëm kompania kineze do të ishte e përgjegjshme.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

- Qëndrimi sipas Letrës Standarde për Tenderuesin e eliminuar është se bënë diskriminim të prodhuesve më seriozë në botë në favor të ofertës më të shtrejtë Kineze.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Përmes interpretimit diskriminues të dosjes së tenderit Autoriteti Kontraktues dhe Buxheti i Republikës së Kosovës dëmtohet në vlerë saktësisht 627,000.00 EURO.

Neni 26, paragrafi 4.2.

- Kontrata me ofertuesin e dytë nuk mund të nënshkruhet për shkak se Vlera e ofertës dyshohet se tejkalon Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve, dhe në procesin e qasjen në dokumetet e tenderit është refuzuar të jepet deklarata. Oferta e dytë ka cmime të cilat janë për 108% më të shtrejta se çdo herë tjetër kur është blerë i njejti produkt në 5 vitet e fundit.

DEKLARATA

Autoriteti Kontraktues për LOT 24 eliminon si të papërgjegjshëm ofertën e Medical Group ShPK, e cila sipas autorizimit ka përfaqësuar kompaninë më serioze Amerikane Pfizer, dhe synon të shpërblejë me Kontratë Operatorin LIRI-Med, i cili sipas autorizimit ka përfaqësuar kompaninë Kineze shumë më të shtrejtë, duke dëmtuar Buxhetin e Kosovës sakt për. 627.000.00 Euro. Kjo me arsyetimin e paqëndrueshëm dhe të pabazuar se përkundër se produkti i Operatorit Ekonomik të eliminuar e përmban dozën brenda kufijve të specifikuar në Dosie të Tenderit nuk përputhet volumi e kërkuar për atë dozë.

Në mënyrë të thjeshtuar, nëse me tender kërkohej paracetamol i cili ka dozë prej 500 mg - deri në 1000mg për të trajtuar gripin, Medical Group LLC ka ofertuar me paracetamol të kompanisë më të njohur në botë me dozë 700 mg. Përkundër kësali, Medical Group ShPK është eliminuar për shkak se volumi/madhësia e hapit është më e vogël, e i cili fakt paraqet efekt pozitiv nga aspekti mjekësor. Sa më e vogël volumi/madhësia për të njejtën dozë, aq më mirë. Dhe për këtë vendim buxheti Kosovës synon të furnizohet nga kinezët dhe të paguaj 627.000.00 Euro më shumë.

Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Autoriteti Kontraktues ka eliminuar Operatorin Ankues Medical Group ShPK me arsyetimin se "OE Medical Group per lotin 24 nuk e ka ne Autorizimin për Marketing, qe dozat e produkteve te ofruara, janë në përputhje të plotë si ne Dosje te tenderit. Eshte kerkuar doza 2000-6000 IU/0.4 ML,ndersa është ofruar 2000.IU/0.2ml"

Për të vlerësuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, duhet analizuar Dosja e tenderit dhe Kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në pikën 9.1 dhe 9.2. të FDT, specifikohet se në lidhje me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Operatorët Ekonomik duhet të plotësojnë Kërkesat në vijim:

2. Te dëshmohet se është i regjistruar me autorizim për marketing nga AKPM, me dozën e produkteve siç është kërkuar.

Ndërsa sa i përket Kërkesave dokumentare:

2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPM sipas UA 01/2015, me dozën e produkteve siç është kërkuar.

Andaj, Kërkesë e vetme e Dosjes së Tenderit, sikurse specifikohet me pikën 9.1 dhe 9.2 të fletës së tenderit është doza e produktit sikurse dëshmohet me Autorizim Marketing. Në përputhje me këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit, Specifikacioni Teknik i detyrueshëm ka përcaktuar se doza e kërkuar për LOT 24 është:

LOW MOLECULAR WEIGHT HEPARIN shiring e mbushur/sol per inj 2000IU-6000 IU/04ml s. c. d&iv Dozat duke filluar nga 2000 IU njëri deri në 6000 IU njësi janë në përputhje të plotë me dosjen e tenderit. Andaj ofertat e operatorëve ekonomik të dorëzuara me doza brenda këtyre njësive 2000 IU deri në 6000 IUjanë të përgjegjshme.

Oferta e Medical Group ShPK, e cila me Autorizim ka përfaqësuar prodhuesin Amerikan Pfizer, ka qenë për këtë produkt me dozën prej 2500 IU. Kjo dëshmohet edhe me Autorizim Marketingun e bashkangjitur në këtë Kërkesë dhe në Ofertën e dorëzuar.

Duke qenë se Operatori Ekonomik Ankues Medical Group shp.k. ka paraqitur ofertë për produkt me

dozë prej 2500 IU njësi, oferta e Medical Group ShPK është tërësisht e përgjegjshme.

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar Ministria e Shëndetësisë tregon se fare nuk e ka analizuar ofertën e Medical Group ShPK. Në letrën Standarde Ministria e Shëndetësisë arrinë në përfundim se Medical Group ShPK ka ofertuar me produkt me dozë prej 2000 IU njësi. Kjo tregon se Autorizim Marketingu i Medical Group ShPK nuk është analizuar dhe vlersuar fare.

Argumentin e mundshëm se doza e produktit të ofertuar nga Medical Group ShPK është në përputhje me dosjen e tenderit, por volumi në të cilin është dispersuar, tretur doza e bënë ofertën e papërgjegjshme, është argument i kundërligjshëm.

Fillimisht, volumi në të cilin është dispersuar doza nuk është kriter për vlerësimin e përgjegjshmërisë së ofertës. Kriter i vetëm sipas pikës 9.1 dhe 9.2 është doza e produktit.

Së dyti, volumi në të cilin është dispersuar doza është tërësisht i parëndësishëm edhe nga aspekti mjekësor edhe nga aspekti klinik. Si ilustrim, nese mirren dy doza me 2500 IU, dhe atë njëra me volum 0.2ml dhe tjetra me volum 0.4ml, të dy produktet gjithmon do ti kenë

2500 IU dhe asnjëherë efekti klinik i ketyre 2500IU nuk do të ndryshoj pa ma marrë parasysh volumin 0.2ml ose 0.4 ml.

Sa më i vogël Volumi me dozë të njejtë gjithmon rekomandohet më tepër nga Mjekët klinicistë për shkak të efektve anësore që volumi i madh i ka gjatë administrimit dhimbja dhe bollusi subkutan.

Andaj, eliminimi i Medical Group ShPK për shkak se ofron volum më të favorshëm për doza sipas dosjes së tenderit është i parëndësishëm.

Për më tepër, operatori i rekomanduar për Kontratë me produktin kinez është i papërgjegjshëm për shkak se Autorizim Marketingu i ofruar nuk përmban informacioni për dozën sipas njësive ndërkombëtare IU. Gjatë inspektimit të dokumenteve është vërtetuar se Autorizim Marketingu i produktit kinez nuk përmban të dhëna për dozën sipas njësive Indërkombëtare IU.

Andaj, nuk është fare e qartë se me çfarë ekspertize apo metodologjie ata kanë bërë konvertimin në njësi ndërkombëtare përderisa Autorizim Marketingu nuk përmban asnjë informacion të dozës sipas njësive ndërkombëtare.

Përfundimisht, produkti i LOT 24 nga Lista Esenciale asnjëherë nuk është paguar më shtrejtë se sa është rekomanduar për këtë aktivitet tenderues për Liri-Med. Çmimi për njësi i Ofertës së Liri-Med të rekomanduar për Kontratë në këtë aktivitet tenderues është 3.83 Euro për njësi. Në anën tjetër, nëse shikohet se sa është blerë i njejti produkt në vitet paraprake del se çmimi i këtij produkti ka qenë 1.84 Euro. Kjo sipas statistikave të vetë Ministrisë së Shëndetësisë, Analiza e produkteve të listës esenciale e shpallur në web faqen e Ministrisë së Shëndetësisë. Andaj, në krahasim me vitet paraprake kemi një shtrejtim të të njejtit produkt me 108%.

Në kërkesën për Qasje në Dokumente Zyrtare është Kërkuar edhe qasja në Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së fondeve, dhe një kërkesë e tillë është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues pa asnjë arsyetim. Ka dyshime se buxheti për këtë LOT është tejkaluar me këto çmime të rritura prej 108%.

Andaj, bazuar në argumentet më lartë, me respekt kërkohet nga ana e Autoritetit Kontraktues që pas shqyrtimit të kësaj Kërkese të merrë:

VENDIMI

I. **Aprovohet** si e bazuar Ankesa e Operatorit Ankues Medical Group ShPK

II. **Obligohet** Autoriteti Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me pretendimet Ankimore të Aprovuara.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 04.01.2017

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizim/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 31.01.2017

Data e hapjes së ofertave .....31.01.2017-14:00^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 24 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.
2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal.
3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Certifikata e biznesit – kopje.
2. Kopje e Certifikatës se Numrit Fiskal – kopje.
3. Kopje e Certifikatës se TVSH-se – kopje.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
N/A
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
N/A

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
1. Te dëshmohet se operatori është i autorizuar nga prodhuesi.
2. Te dëshmohet se është i regjistruar me autorizim për marketing nga AKPM, me dozën e produkteve siç është kërkuar.
3. Te dëshmohet se është i regjistruar nga AKPM si qarkullues me shumice I produkteve farmaceutike - valide

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Autorizimi nga prodhuesi (me te dhëna mbi prodhuesin: adresa, nr. tel, email, web faqja etj, per mundësi te verifikimit).
2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPM sipas UA 01/2015, me dozën e produkteve siç është kërkuar.
3. Licenca valide nga AKPM si qarkullues me shumice I produkteve farmaceutike.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike për LOT 24:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Phoenix Pharma"	Prishtinë	1,034,480.00€	JO
2.	"Medical Group"	Prishtinë	399,320.00€	JO
3.	"Liri Med"	Prishtinë	1,026,440.00€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Besim Bajraktari - Kryetar i komisionit
- Gezime Pllana - Anëtar i komisionit
- Pash Buzhala - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 07.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....13.04.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....21.04.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	**Liri Med**	**1,026,440.00€**	**1**
2.	**Phoenix Pharma**	**1,034,480.00€**	**2**

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni i ka vlerësuar me kujdes 3 ofertat te pranuara dhe ne baze te dokumentacionit te ofruar 2 oferta janë te përgjegjshme dhe komisioni rekomandon se oferta e OE "Liri Med" është e përgjegjshme për dhënie te kontratës me çmim me te ulet te ofruar 1,026,440.00.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti teknik sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:
OE "Medical Group" për Lot 24, nuk e ka ne Autorizim Marketing, qe dozat e produkteve te ofruara janë ne përputhje te plot si ne dosje te tenderit. Është kërkuar qe doza 2000-6000IU/0.4 ml, ndërsa është ofruar 2500IU/0.2ml.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues për shkelje te nenit 7 te LPP-se, sqaron se gjate ekzaminimit te shkresave te lendes nuk ka vërejtur diskriminim apo trajtim te pa barabartë te operatoreve ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit poashtu edhe ne lidhje me disponueshmerine e fondeve, eksperti shqyrtues, sqaron se ne dosjen e AK-se, gjendet deklarata e Disponueshmerisë se fondeve ne vlerë prej 2,000,000.00 euro.

Sa i përket pretendimit te OE ankues për shkelje te nenit 27 dhe 28 te LPP-se, me arsyetimin se AK-ja, ka hartuar dosjen e tenderit ne mënyrë diskriminuese, eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se gjate fazës se kritereve nuk ka pasur pyetje/përgjigje lidhur me Lot 24.
Poashtu lidhur me kete pretendim eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te dispozitave te nenit 108/A, 3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Ne rastin konkret për shkeljet e supozuara nga OE ankues, sipas dispozitës se lartpërmendur është dashur qe te ushtroj ankesë ne fazën e kritereve.
Ne lidhje me këtë eksperti teknik sqaron se përveç OE te rekomanduar për kontratë, ne listën e AKPM gjenden te regjistruara edhe produktet te kompanive tjera siç është rasti edhe i OE te tret me radhë i cili ka ofertuar ne këtë aktivitet te prokurimit - phoenix pharma e qe është me substancë Clexane – 4000 anti – xa/0.4ml. prandaj, ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit te OE ankues ne lidhje me autorizim marketingun e OE te rekomanduar për kontratë, i cili pretendon se autorizimi i OE te rekomanduar për kontratë nuk i përmban te dhënat e nevojshme, eksperti teknik sqaron se autorizim marketingu i dorëzuar ne ofertën origjinale te OE te rekomanduar për kontratë i përmban te dhënat e nevojshme për faktin se ne autorizim është i shënuar Njësia prej 40 mg/0.4ml e cila mbas konvertimit i bie qe 40 mg janë te barabarta me 4000IU/0.4ml.

Sqarimi nr.3

Eksperti teknik, lidhur me arsyen e eliminimit te OE ankues sqaron se AK-ja, ka kërkuar qe produkti te jete 2000IU-6000IU/0.4ml s.c & i.v. Ne ofertën e tij OE ankues ka ofruar produktin prej 2500IU/0.2ml, do te thotë se ka ofruar koncentrik dhe vëllim me te vogël se sa është kërkuar ne listën esenciale te Ministrisë se Shendetesise.
Eksperti teknik, vlerëson se OE ankues ne lidhje me pretendimin se ka ofruar produktin adekuat te AK-ja, nuk qëndron.
AK-ja, ne rastin konkret MSH-ja, ne baze te shpalljes se tenderit furnizim me barna nga lista esenciale Lot 24 ka kërkuar LOW MOLECULAR WEIGHT HEPARIN shiring e mbushur/sol për inj 2000IU-6000 IU/04ml s.c.&i.v, ndërsa OE ankues ka ofruar substancën Heparin te regjistruar pran AKPPM-se, me MA certifikatë 2500IU/0.2ml.
Shkencërisht nga aspekti klinik dhe farmakologjik vlera e koncentrimit te Heparines 4000IU është pothuajse dy here me e madhe se Heparin 2500 IU. Kërkesat nga mjeket e klikave shëndetësore kane qene për koncentrik 4000IU dhe 6000IU dhe ne rastin tone ne qofte se pacienti ka nevoj per trajtim me këtë substancë dhe ne kemi ne dispozicion Heparin 2500IU atëherë duhet te bëjmë dy e me tepër injektime te pacientet. Duke i ditur anët negative te injektimeve te cilat janë: komplikimet e ndryshme

si psh: abcesi, gjakderdhjet ne vendin e injektimit (mavijosje), dëmtimet e enëve te gjakut dhe nervave periferik, dhimbje ne vendin e injektimit, infeksionet dhe reaksionet alergjike janë disa nga komplikimet qe mund te shkaktohen nga aplikimi i injektimeve, me ç'rast edhe mjeket e klinikave decidivisht kane kërkuar qe furnizim te behet me heparinen me koncentrik me te lart për ti ikur aneve anësore te shkaktuara nga injektimet e shpeshta.
Pra, ne rastin konkret AK-ja, ka kërkuar decidivisht qe: LOW MOLECULAR WEIGHT HEPARIN shiring e mbushur/sol për inj 2000IU-6000 IU/04ml s.c.&i.v, pe te cilin edhe OE ankues ka qene i njoftuar me kohe, pra ne njoftimin për kontratë te publikuar ne ueb faqen e Krpp-se, për te cilin edhe është dashur qe te reagoj apo edhe te parashtroj kërkesë për rishqyrtim pran AK-se. Mirëpo siç është përmendur edhe me lart OE ankues nuk ka kërkuar sqarime dhe nga te gjeturat rezulton se ne AKPM, ka te regjistruar edhe disa kompani tjera te cilat kane te njëjtin produkt me koncentrik sipas kerkeses se listës esenciale te barnave.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Shëndetësisë (MSH)**, për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me barna nga lista esenciale" Lot 24**, me numër të prokurimit: 206/17/086/111, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës, ndërsa ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar.